

INTERVISTË ME ADEM MIKULLOVCI

Prishtinë | Data: 16 maj, 2018

Kohëzgjatja: 74 minuta

Të pranishëm:

1. Adem Mikullovi (I intervistuari)
2. Aurela Kadriu (Intervistuesja)
3. Donjetë Berisha (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Aurela Kadriu: Zotri Mikullovc, a na tregoni pak për kujtimet e juja t’hershme të femënisë? Për familjen ku jeni lindë, për vendin në të cilin jeni rritë, çka mbani n’mend prej femënisë?

Adem Mikullovc: Oh, kjo pyetje është oqean pa fund. Shumë mbaj n’mend, bile pak tepër mbaj n’mend. Unë jom, kom lindë në Vushtrri, po jemi shpërngulë, prindërit jonë shpërngulë në Mitrovicë. Kështu që, shkollën fillore, e t’mesme i kom kry në Mitrovicë. Dhe kujtimet e mija jonë kryesisht t’lidhura ma tepër për Mitrovicën se sa për Vushtrrinë. Kom lindë në një familje, si t’them, si thojshim na, mesatare qytetare. Kom lindë në të njejtën dhomë ku ka lindë babëgjyshi im, n’qatë dhomë ka lindë baba im, n’qatë dhomë kom lindë dhe unë (buzëqeshë). Po s’arrita me lindë djalin n’atë dhomë, lindi knej, në Prishtinë.

Kom shumë kujtime. Kom kujtime që në monodramën time i thojsha publikut, “Erdha në këtë botë në një varfëri teknike, kur s’kemi ditë çfarë është telefoni, s’kemi pasë as telefon, s’kanë pasë as makina, as kurgjo. Kur krejt mahalla e ka pasë një telefon. Dhe p’e lo këtë botë në një rrëmujë teknike me aq aparatuara, aq interneta, aso dreqnie, sa që s’di a ka qenë ma mirë ai fillimi im, apo ky mbarimi im.”

Kësi soji e kalova rrugën e jetës time. E kalova rrugën e jetës time dhe erdha te fundi. Dhe kur ndalem dhe shikoj rrugën që kom kalu, e shoh një rrugë plotë gropa, plotë hendeqe, baltë, lloqkovinë, breshën, shi, aty ktu ndonji lule që ka çelë n’jetën time. Ndonji lule e dobët, që pika e parë e shiut që i ka ra e ka plandosë për tokë. Për mu jeta ka qenë, s’po ankohe, por po mundohem ta flas t’vërtetën, shumë shuplaka. Dhe jeta e çdo njeriu është ma tepër shuplaka se sa puthje.

Kur i udhëheqa seancat konstitutive të kuvendit, iu recitova n’fillim një vjerrshë të Azem Shkrelit, që është shumë dhomëthënëse, “Ndalem dhe shikohem në pasqyrë, drejtë në sy, dhe nuk di a me puthë vetën a me pështy”. Çka me vazhdu tash?

Aurela Kadriu: Në çfarë familje jeni lindë?

Adem Mikullovc: Po thashë në një familje...

Aurela Kadriu: Çfarë kompozicioni, çfarë përmbamje ka pasë familja?

Adem Mikullovc: Kom lindë në familje mesatare, po mendoj qytetare. Ka qenë baba, nana, katër vllazën, unë i pesti dhe motra. Kallabllak femijë. Jemi rropatë qashtu, si kemi mund. Jemi rritë, jemi shkollu të gjithë. Do kanë vdekë, do kanë metë ende gjallë.

Aurela Kadriu: Çka kanë punu prindërit? A kanë punu?

Adem Mikulloci: Prindërit e mi kanë qenë bahçebanxhi. Na në Vushtrri i kemi, t'parët e mi kanë mbjellë bahçe, kopshte, po mendoj, po ma tepër osht' përgjegjja ma e saktë, me thonë bahçe. Se domethonë kanë mbjellë bereqetet, boston, e specat, e patligjona, e patate, e të gjitha këto prodhimet tjera. Në aso familje jom rritë une, dhe ka mbetë ai dell në mu, që tash edhe në shtëpinë time e kom bo një bahçe t'vogël, ku po mundohna unë... edhe që s'po kom haber, se s'jom marrë me këtë punë, po mundohna t'i kthehem lirit tim të hershëm, t'parëve t'mi, t'mbjelli domate, patate e tjera, e tjera.

Aurela Kadriu: A e kanë siguru jetesën prej tyre, a i kanë shitë, a kanë bo tregti?

Adem Mikullovc: E kanë siguru jetës prej tyre, fort mirë. Ma mirë se sa tash. Fort mirë kanë qenë. U punu gjithë verën, jonë mledhë të lashtat në vjeshtë, kanë qenë prodhimet e dimrit, si lakra, e tjera, e tjera. Dhe kemi pasë një jetë shumë t'mirë dhe komode.

Aurela Kadriu: Në cilin vit jeni shpërngulë në Mitrovicë?

Adem Mikullovc: Jemi shpërngulë dikun në vitin '54. Une... s'e di besa, '53, a '54 atje kemi shku. Kështu që, veç klasën e parë fillore e kom kry në Vushtrri, e mandej prej t'dytës e më tutje kom vazhdu në Mitrovicë.

Aurela Kadriu: E qysh ka qenë Mitrovica, çfarë qyteti ka qenë n'atë kohë? Qysh e mbani n'mend?

Adem Mikullovc: Paj Mitrovica, çka me t'thonë qytet pas të gjithave ma homogjen, sikur se Vushtrria, si çdo qytet tjetër i Kosovës. Lidhen familjet me familje, na fmija nëpër shkolla, me sport me... ka pasë një harmoni, ka pasë një lezet jeta atëhere. E tash nuk osht' ajo, tash osht' një vrap i madh pas, posaqërisht rinia, mas punësimi, avansimi, shkollimi e tjera, e tjera. Na e kena pasë shumë mirë. N'shkollë kemi pasë ma pak nxanës. Mbaj n'mend kur e kom kry maturen e gjimnazit në Mitrovicë kemi qenë 23 nxanës. Sot i i ka katërdhjetë a pesëdhjetë a, në një klasë.

Aurela Kadriu: Në cilën lagje keni jetu në Mitrovicë?

Adem Mikullovc: Kom jetu në lagjen e ashtuquajtura "Lagja e Boshnjakëve", përtej urës të Mitrovicës. Ka qenë xhamia, tash osht' rrënu, pranë xhamisë...

Aurela Kadriu: Në veri a?

Adem Mikullovc: Në veri, në veri. Si kalon ura, xhamia ka qenë, pranë xhamie, shtëpia jonë ka qenë aty.

Aurela Kadriu: Deri kur keni jetu në Mitrovicë?

Adem Mikullovc: Në Mitrovicë kom jetu deri në vitin '63, '64, kur kom shku në Akademi në Beograd me studiu. Deri e kom kry shkollën e mesme aty kom qenë në Mitrovicë.

Aurela Kadriu: Shkollën fillore ku e keni kry?

Adem Mikullovc: Në Mitrovicë e kom kry shkollën fillore.

Aurela Kadriu: Cila shkollë ka qenë?

Adem Mikullovc: Ka qenë shkolla “Muharrem Bekteshi”.

Aurela Kadriu: Çka mbani n’mend prej shkollës fillore?

Adem Mikullovc: Po çka mbaj n’mend... mbaj n’mend që një fazë, në një fazë erdh drejtor i shkollës u bo vllau im. Dhe unë mendova që fitova njëfarë, si të them, lehtësimi, muj me mungu prej mësimi. Po nuk më doli ashtu. Kërsitën shuplakat, kërsitën atëhere vizoret. Kemi pasë diciplinë në shkollë aso kohe. Edhe ndërroi situata. Mbaj n’mend shokë shumë nga shkolla fillore. Përgjithësisht, thuja se t’gjithë kanë vdekur, kemi metë tre a katër, aty, këtu që shifemi ndonjiherë. Kanë shku t’gjithë. Kanë shku t’gjithë.

Aurela Kadriu: Shkollën e mesme...

Adem Mikullovc: E shkollën e mesme gjithashtu e kom kry në Mitrovicë. Gjimnazi atë botë quhej “Silviera Tomazini”. Kom pasë profesorët, t’gjithë profesorët e mij që i kom pasë në gjimnaz, më vonë kur u hap universiteti në Prishtinë, kalunë në Prishtinë u bonë profesorë universiteti. M’kanë dhanë mësim, Latif Berisha, Latif Mulaku, Ahmet Maloku, Musa Gashi, Shenasi Koronica. Profesorë eminent, profesorë me emër kemi pasë.

Mandej kemi pasë tjera raporte na me profesorët, tjera raporte kanë fmija sot. P’e shof une, mësuesi po rrin me nuanës, po pinë cigare bashkë, s’di çka. Na me, kemi pasë një distancë t’madhe mes neve dhe profesorëve. Une bile ka rastisë kur jom ardhë këtu në Prishtinë, deri para dy vjetëve, tash ka vdekë, profesori im i matematikës, sa herë e kom taku i kom nxjerrë durët prej xhepave. Ka mbetë ai respekti që e kom pasë profesor në gjimnaz.

Edhe osht’ interesant lidhja me to, me profesorin e matematikës, Shenasi Koronicën, i cili në vitin e tretë gjimnaz më zuri që nuk e dija tabelën e shumëzimit. Dhe une ju betohem sot e kësaj dite, nuk e di tabelën e shumëzimit. Tash t’më thotë dikush, “Këtu e ki një grumbull parash, shtatë herë tetë, këtu i ki tetë herë gjashtë”. Unë nuk di cilën me marrë, s’di ku ka ma shumë cila bënë ma shumë.

Dhe profesor Shenasiu më tha aso kohë, “Sikur mos të ishin landë tjera, sinqerisht të kisha thonë me lanë shkollën, se s’do të thotë t’gjithë me kry shkollë. Kemi nevojë për argat, për punëtor, për zanatli. Se ti s’je kërkun hiç për matematikë”.

Aurela Kadriu: A ishe i mirë në lëndët tjera?

Adem Mikullovc: Në landët tjera i kom pasë të gjitha pesëshe, bash t’gjitha. Dhe përherë, prej vitit t’parë, deri e kom kry gjimnazin, ma kanë falë ka një dysh t’coft, ose tresh t’coft për mos me m’ngelë, se s’kish kuptim me m’ngelë kur i kisha dhjetë-dymdhjetë pesëshe e një njish në matematikë. E mbaj n’mend një here tha profesori i matematikës, se u ndalëm shumë te profesori i matematikës...

Aurela Kadriu: S’ka lidhje.

Adem Mikullovc: Më zuni dhe më tha, “Minus nji”. Tash s’di a m’tha, “Minus nji”, a “Nji minus”. Une thashë, “Nejse”. Tha, “S’po kupton, duhet me mësu, e me mësu, e mësu, e mësu me marrë njish, me t’ngelë unë. E me mësu, e me mësu, e me mësu shumë, me mujtë me marrë nji dysh t’coft e me kalu klasën”. Qaq kom qenë, vërtetë, sot e kësaj dite analfabet.

Aurela Kadriu: Çfarë qyteti, a ka qenë qytet industrial Mitrovica?

Adem Mikullovc: Mitrovica ka qenë qytet, edhe osht’ industrial. I thojshim, asokohe thojshim Manchesteri i Kosovës. Paramendojeni vetëm Trepça punësonte, njëzet mijë, njëzet e dy mijë punëtorë. Do të thotë njëzet mijë familje kanë qenë t’sigurume me roga, me paga t’mira, me jetë bukur, t’them ekonomikisht t’qëndrushme. S’ka pasë veç të Mitrovicës, ka pasë prej krejt Kosovës.

Mandej ka qenë fabrika e akumulatorëve, ka qenë nji fabrikë me mekanikë, me automjete, s’di qysh u thirrë ajo për Zotin. Dhe ka qenë industria e drurit, dhe ka qenë qytet industrial. Qyteti ma i pasun, ma i begatshëm i Kosovës ka qenë Mitrovica.

Aurela Kadriu: A ka pasë shumë njerëz prej vendeve t’ndryshme të Kosovës aty?

Adem Mikullovc: Ka pasë shumë. Ka pasë shumë ardhacak në Mitrovicë, se mu me faktin e punësimit në Trepçë, edhe në fabrikën e akumulatorëve, edhe fabrika e dërrasave, e drurit, kanë ardhë prej krejt Kosovës. Kështu që, Mitrovica osht’ e njoftun që ka shumë edhe gjakovarë, interesant, një numër i konsiderueshëm i familjeve gjakovare kanë ardhë mu për shkak të këtyne mundësive të punësimit, kanë ardhë dhe jonë vendosë në Mitrovicë. Dhe kanë mbetë tash tradisionisht, sot e kësaj dite, pasardhësit e tyre kanë ngelë në Mitrovicë.

Aurela Kadriu: E familja juaj pse vendosi me, me kalu, a ju kanë tregu nodnjihere, prej Vushtrrisë në Mitrovicë?

Adem Mikullovc: Po, m’kanë tregu, si jo. Baba im i ndjerë ka dalë, u shpërngulë në Mitrovicë pas t’gjithave tu e llogaritë, ka shumë fëmijë e i çon nëpër zanate e dalin sa ma shpejtë n’bukë t’vet. Po nuk ndodhi ashtu, na t’gjithë krymë fakultete, t’gjihë u shkollum, nuk dolën planet e tij. Ky ka qenë njëri nga shkaqet. Ka qenë shkaku tjetër që disa shokë t’tij, dy a tre, se tash s’jom i sigurtë, jonë shpërngulë nga Vushtrria në Mitrovicë dhe ka shku bashkë me ta me qenë bashkë në Mitrovicë. Kemi qenë në Mitrovicë.

Aurela Kadriu: Çfarë drejtimesh keni marrë ju edhe vllaznitë edhe motra juaj, po mendoj, çka kanë studiu?

Adem Mikullovc: Po, kryesisht vllazënit e mi jonë marrë kryesisht me shkenca teknike, elektroteknikën, inzhinierinë, vllau i madh ka qenë albanolog, e tjerët qesi teknikë krejt, matematikë e qesi sende, kontra prej meje, t’kundërtën time.

Aurela Kadriu: E ka ju ka ardhë juve kjo prirje...

Adem Mikullovc: Nuk e di, nuk e di, kur e kreuva maturën u bo debat i madh në familje çka të studioj dhe vishin propozime të shumta. Prej, çka di une, fizikë, matematikë, e astronomi, e gjuhë e... gjeografi e s’di çka. Im at thonte, “Avokat, avokat le t’bohët thiu se i blun goja si gjakalla e mullinit edhe dynjenë ka me bo kahre”. Ndërsa nana ime e ndjerë thonte, “Doktor, doktor. Është hall ligë e

ndoshta ia gjenë ilaqin vetit”. Bile, bile, e kom kto të sigurtë, pastrusi, lustruesi i këpucëve që ishte në mahallë tonë edhe ai u përzi në këtë muhabet çka me studiu une.

Aurela Kadriu: Çka thojke ai?

Adem Mikullovc: “Profesor, profesor bonu. Edhe s’ka ma mirë se profesor, je zotni për jetë”. Unë shkova në Beograd për provim pranues, se këtu s’kemi pasë fakultetin, n’mjekësi dhe rashë në provim pranues. Por njëkohësisht i pata do dokumentet edhe në Akademi për teatër e film, e shkova atje. Atje u pranova.

Aurela Kadriu: Cilën e dojshit më shumë ju?

Adem Mikullovc: Artin, gjithsesi. Ato veç me ja bo qefin babës. Dhe këtu baba ma ka thonë një fjali që sot e kësaj dite m’ka mbetë në kokë dhe m’kujtohet. Kur i tregova që do t’bahem aktor, tha, “Ani djali jem, veç une kom pasë qef që nesër me marrë ti grunë për dore e me shku në teatër me pa shfaqje. E tash tjerët i marrin gratë për dore e vijnë me t’pa ty ti kah lunë shfaqje”. Dhe këta kurrë s’e kom harru. S’kom lujtë shfaqje n’teatër, a jom prej aktorëve që ka lu ndoshta, mes atyne, jo ma s’shumti, po mes atyne që kanë lu ma s’shumti, atyne që kanë lu shumë role në teatër. S’kom lujtë shfaqje pa m’u kujtu fjalët e babës tim.

Dhe vjen im at, asokohe e kemi pasë një shfaqje, “Duke pritur Godon”, qat vit e murrë autori i veprës nobelin për letërsi. Na e vumë shfaqje aty, edhe llogaritet si një nga shfaqjet ma t’mira. Lujshin rolin kryesor une me me Shani Pallaskën, por ishim veshun si leckana. Bash leckana, shumë me rroba t’çkyme shumë. E me mjekërr t’pa rrome, e mos vet! Dhe vjen im at sheh shfaqjen. Edhe m’tha mas shfaqjës, “Bile një parë tesha kanë mujtë më ju ble m’i veshë, çka i keni bo ksi soji?” A din? Nuk e kuptojke...

Mund të them se, sa do t’them sensin tim për humor e kom trashëgu prej babës. Ndërsa sensin tim për dramë, se kom bo mjaft drama televizive dhe seriale, s’di a i keni pa krejt a jo, çka keni pa, i kom pasë më tepër prej nanës. Nana na ka rritë tu na tregu tregime t’dhimshme, tregime dramatike, legjenda të ndryshme. Dhe m’ka mbetë qaj dell, qaj përjetimi emocional për ngjarjet e dhimbshme, ngjarjet e randa. Dhe aty m’ka shku më tepër drama.

Dhe kur jom kthy prej studimeve në Prishtinë, në teatër, kom ardhë, unë kom mend që do t’luj vetëm drama. Dhe komedinë s’e kom dashtë hiç, dhe sot e kësaj dite nuk e du komedinë. Po kush m’shtyni n’ujërat e komedisë e mbeta n’to. Mandej edhe serialet, televizioni, hajt, hajt, humor i kërkohej, mbeta n’humor. Kështu që tek kur fillova të bëjë vet drama televizive, të realizoj seriale televizive, atëherë ju ktheva prapë dramës, dashnisë time t’përditshme, drama osht’ ajo që osht’.

Megjithëse, ende kom mbetë n’luftë edhe me kolegë edhe me kritika, se po mendoj dramën e mija, filmat e mi televiziv, edhe serialet, “Zogjët e luftës” e të tjerë, jonë plotë emocione. Dhe njerëzit vazhdimisht kanë qajtë kur i kanë shiku. Dhe i qujshin patetike. Dhe më vjen keq që sot e kësaj dite s’po dijnë me bo dallimin mes emocionalës dhe patetikës. Patetike osht’ kur folë me za artificial. Reshat Arbana, aktori nga Tirana e ka zanat, ai osht’ patetik kur reciton, “Se pasha tokë, e pasha qiell”. Ajo osht’ patetizëm.

Ose m’kujtohet, poezinë e pata dëgju tu e recitu, “Nënë moj, mbaj zi për vëllanë, me tre plumba na e vranë...” Kjo osht’ patetike. Po nëse e thu me plotë dhimbje, “Nënë moj, mbaj zi për vëllan, me tre

plumba na e vranë, na e vranë, na e shanë, na i thanë tradhëtor...” Osht’ emocion. Po kom një përshtypje që kritikët tanë, gazetarët tanë, s’po dijnë me tërheqë atë vizën e kuqe mes patetikës dhe emocionalës.

Aurela Kadriu: Çfarë tregimesh iu kallxojke nana?

Adem Mikullovc: Tregime, ka pasë tregime, ka pasë tregim për një vajzë, Duda, e cila ka qenë e dashunume në një boshnjak, e prindët s’e kanë lonë m’u martu edhe ka shku ka hypë në një kodër, osht’ te Ibri, mas, skej Mitrovice, Dudinkash i thojshin, Guri i Dudës, serbizëm, Dudinkash. Dhe ka hypë n’atë guri, ka këcy poshtë, ka bo vetëvrasje. Një nga tregime për shembull. E tregime t’ngjashme m’ka tregu nana.

Aurela Kadriu: A ka pasë jetë kulturore në Mitrovicë, ndoshta po mundohna me eksploru çka ka mujtë me iu shty juve në aktrim. A ka pasë farë jete kulturore në Mitrovicë?

Adem Mikullovc: Ka pasë, ka pasë. Shiqo një kohë ka qenë teatri profesional. Dhe unë po ju them t’drejtën, kom qenë i dhanun pas sportit, për futboll e kom dhonë shpirtin, sot e kësaj dite e du shumë. Dhe unë s’kom pa shfaqje deri vitin e dytë a tretë gjimnaz, s’kom pa asnjë shfaqje hiç, as... e kom ditë që ekziston teatri po nuk m’ka interesu asnjë fije. Dhe një natë, ky osht’ tregim interesant, një natë ty kalu pranë të ashtuquajturit Domit të Kulturës, ashtu i thojshim, e pashë njerëzit po presin për shfaqje. Edhe une hy n’mbramje me pa shfaqje, dhe ishte shfaqja “Vraga” i një shkrimtari të Bosnjës, Josef Pleshqi, kur rolin kryesor e lunte Muharrem Qena, Melihatja, Lezja, Xhevati, Abdurrahman Shala, Istref Begolli.

Salla plotë, jom ulë në skej, në një qosh edhe ishte shfaqja e parë që shikoja. Dhe m’ka prekë aq shumë, gjatë gjithë kohës kom qajtë si një qen i vogël, si një këlysh. Dhe mandej erdhi shfaqja “Shpirtat”. Shkova e pashë shfaqjen “Shpirtat”. E një shfaqje u konë, Lezja e lunte rolin kryesor, kjo, ah tash duhet me ndalë se m’u ndal truni... “Ana Frank”.

Donjeta Berisha: Veç vazhdoje domethonë, vazhdoje ku keni mbetë, te shfaqja “Ana Frank”, edhe prej qatyhit e vazhdoj...

Adem Mikullovc: Po, mirë. Mandej erdhi shfaqja “Ana Frank” me Leze Qenën në rolin kryesor. Dhe u mahnita, u çmenda mas teatrit. Aq shumë më mbërtheu, më kapi teatri sa që erdha prej Mitrovicës në Prishtinë me pa edhe një here “Ana Frank”. Por osht’ interesant kur e pashë shfaqjen “Vraga”, atë shfaqjen e parë, më mahniti konflikti i dramës. Si u përlanë, u vranë, u kërcnënë mes veti, u inatosën, u rrahën. Dhe menxi pritja me pa çka do bahej me këta njerëz kur t’kryhet shfaqja.

Dhe ishte befasi për mu kur i pashë Muharremin e Istrefin ka bisedojnë normal. Abdurrahmani ka bisedon normal me ta, Xhevati qashtu. Dhe s’mujsha me kapë atë sens, çka osht’ shfaqje, çka osht’ jeta private. Ajo më mahniti ma s’shumti. Do të thotë, krejt çka pasna pa n’shfaqje paska qenë artificiale. Këta qenkan shokë, këta s’po urrejkan mes veti, s’po rrehkan mes veti. Se une thuja që pritsha që do të kacafyten edhe kur t’kryhet shfaqja këta, u bonë lesh mes veti, s’ka mes tyne mo muhabet.

Kjo më ka pasë, si me thonë ka qenë ajo xixa që m’ka ngacmu kaq shumti, dhe pata vendosë aktor dhe vetëm aktor. Aq ma tepër që nga Mitrovica ishin edhe Muharrem Qena, Xhevat Qena, aktorë të Mitrovicës. A nana ime e ndërë kishte bukur njëfarë shoqnie me nanën e tyne, pishin kafe bashkë,

vishin e shkojshin mes veti. Qashtu u lidh puna që ju kushtova plotësisht teatrit, edhe shkova në teatër.

Aurela Kadriu: Qysh erdh puna që shkutë në Beograd, para se me shku qysh vendosët me shku?

Adem Mikullovc: Po e lexova konkursin, u interesova mes konkursit, provimi pranues. Po une babës i thashë po shkoj për mjekësi. I bona dupllo dokumentat, duplikatin, i dërgova dhe në Akademi. E shikoni, këtu pak ka hupë ajo, megjithëse edhe këtu ende ekziston ajo, në Akademi osht' një numër shumë i vogël i studentëve të pranuar. Kemi qenë tetë studentë në vitin parë. Osht' cikli i parë i provimeve, provimi pranues, mandej u pranunë tridhjetë nxanës, studenta. Ata provunë një javë ditë për profesorët, hynë prapë n'provim, edhe u pranunë vetëm tetë, si kinse ma t'talentumit.

Këtu dojsa me thonë, për provim pranues në Akademi, e kom thonë edhe në shfaqjen time, iu kom tregu shikuesve, m'ka ndihmu shumë Bekim Fehmiu. Atëbotë, Bekim Fehmiu ishte në teatrin Jugosllav dhe kishte bo emën, ishte bo aktor i mirë, i cekun, i dallumë. Dhe e merr vesh Bekimi që ka ardhë një shqiptar në provim pranues në Akademi mes, prej aktorëve tjerë, prej studentave.

Vjen m'lypë e m'gjenë mu. M'qiti, dolëm me një kafe, m'qiti n'sitë e në shoshë, "Pse po du mu bo aktor..." I thashë, "Nuk e di". Tha Bekimi, "Shumë mirë, se edhe une nuk e di pse jom bo aktor". Po kur i tregova çka po punoj me profesorin për provimin e dytë, herën e dytë me hi n'provim pranues, Bekimi m'tha, "S'kanë me t'pranu. Këta dojnë emocion, po s'ta panë emocionin tond s'ju intereson tjetër". Kisha fjalën e Mark Antonit, Jul Cezarin, Hamletin edhe një tekst "Letërsia ruse". Tha, "S'kanë me t'pranu". Dhe m'tha Bekimi, "Recitoju diçka, gjej diçka t'dhimshme, t'prekshme, emocionale para profesorëve, në provim pranues".

Dola une para, si Adem me "A", i pari hyna n'provim. Se me "A", Ademi i pari. E fola Hamletin, tekstin e Hamletit, "Të rrosh ose të mos rrosh". Fjalën e Mark Antonit, edhe atë, edhe atë të rusit. Thanë, "Mirë". Thashë, "A bon t'i them disa vargje, një poezi ne gjuhën shqipe". Thanë, "Hajde të dëgjojmë". Ishin 15-16 profesorë, e unë n'skenë. Shkova kadale u afrova, u ula në gjunjë, edhe u mundova sa ma butë, bash vargjet me Luigj Gurakuqin dhe ju recitova, "Nënë moj, mbajë zi për vëllanë". Po e recitova asi soji sikur se kom ardhë me lajmëru nanën që i'a kanë vra djalin.

Aurela Kadriu: A mundeni me...

Adem Mikullovc: Nga ai aspekt ia nisa. "Nënë moj, mbajë zi për vëllanë, me tre plumba na e vranë. Na e vranë, na e shanë, na i thanë tradhtor. Se të deshte kur s'të deshin, se të qante kur të qeshnin, se të vishte kur të zhveshnin. Nënë moj, të ra dëshmorë..." Dhe një profesor bërtiti prej salle, "Nuk di çka na the, se nuk e dijmë gjuhën shqipe, por ti u pranove!" Dhe kjo ka qenë paramendo, krejt puna tjetër ka shku huq, qajo këshilla e Bekimit që me dalë me një gja pak ma emocionale, me një tekst, e bani që u pranova në Akademi.

Aurela Kadriu: Në cilin vit keni qenë në Akademi?

Adem Mikullovc: Kjo ka qenë në '64-shin. Dhe në Akademi m'ka pasë ndodhë edhe një besfasi tjetër e madhe. Erdh një profesor jepte gjuhën, letërsinë greke t'vjetër, t'helenëve, jo t'grekëve. Dhe hini n'klasë profesori dhe tha, befasia ma e madhe e imja ka qenë, s'e harroj kurrë, "Kom dëgju që osht' një shqiptar këtu". Thashë, "Unë jom profesor". Tha, "Hajde t'lutna recitoma një poezi të Fan Nolit". U kthy m'tha, "A e din ti kush osht' Fan Noli?" Thashë, "Unë e di, po ku po e dini ju?". Ai iu spjegoj

studentave tjerë, iu tha, “Fan Noli ka qenë një prift ortodoks, osht’ përkthyesi ma i mirë i Shekspirit në të gjitha gjuhët e botës, për shkak t’ diftongjeve “th” dhe “dh” i’u ka përshtatë më tepër, i ka rikëndu vargjet e Shekspirit”.

Edhe m’tha mu profesori, “Recitoma atë vjershën e cila osht’, e ka muzikën n’veti, qe flet për luftë e ndëgjohet trumbeta e luftës, *rramabam, rramabam* {onomatope}”, bojke kështu me dorë {lëvizë dorën e ti}... Cila osht’ ajo poezi, nuk disha. Fillova, “Anës të Lumenjëve”, nuk osht’. “Plak Topall dhe Ashik”, nuk osht’. “Shën Pjetri mbi Mangall”, nuk osht’. S’di, nuk di... Tha, “Le, s’po e din”. Dhe m’tha, “As Bekimi s’e ka ditë”. Bekim Fehmiu. Dola prej mësimit, ndoshta pak shumë i gjatë ky tregim a? [I drejtohet intervistuesës]

Aurela Kadriu: Jo, jo. Vazhdoni.

Adem Mikullovc: Dola prej mësimit, dhe e takova, se m’patë marrë ilegalisht me flejt në dom t’sudentëve, Gjelosh Gjokaj, piktori. Ai ishte në vitin e pestë, po u njoftumë qashtu rastësisht edhe deri sa m’dulë mu domi i studentëve, fleja ilegalisht te ai. M’pret ai mu edhe m’thotë, Gjeloshi, “Hajde po shkojmë te ura, u hapë një restaurant për student”. Thashë, “Ku?” “Te ura”. {Përplasë duartë në shenjë që iu ka kujtur diçka} Te ura! {“Te ura, te ura, vraponi o burra...” Thom, “Prit”. Kthena une *vrrr* {onomatope} përmas, katin e tretë, shkallëve përpjetë. Isha si lepri, kisha kondicion.

Hi n’klasë, hi n’zyre i thom profesorit, “Profesor m’u kujtu vjerrsha!” “Cila osht’ ajo?” Thom, “Te ura, te ura, vrap...” “Boll, boll! Nesër ki me recitu në orë të mësimit”. Mandej e kom recitu disa herë atë vjershë. E donte dhe e njipte Nolin.

Aurela Kadriu: A na i recitoni?

Adem Mikullovc: Po, jo tash jo. Tash as s’e di përmendsh me t’thonë t’drejtën, e kom harru. E u formu njifarë shoqërie me to, aq ma tepër që n’fund t’vitet t’parë kur jom ardhë unë n’shpi, kom shku me shokë n’deti, ata e ka çu dreqi ka ardhë në Kosovë, u interesu për mu. Ma ka gjetë shpinë time në Mitrovicë, e ka nejtë me babën tem, ata kanë dalë në drekë, iu ka folë, iu ka folë.... Kështu që kur fillon, vazhdonë mësimet në shtator m’tha, “Nëse bohesh sa gjysa e babës tond, mirë i ki punët”. I kishte lonë përshtypje baba im. Çka po di une, çfarë muhabeti kanë pasë këta mes veti muj t’a marrë me mend. Baba im një, as shkollën fillore t’pa kryme, edhe tani gjuhën serbe. Po kanë gjetë gjuhë të përbashkët, dhe kishte, nonstop e përmente atë drekë, atë nejtë që e ka me bo prindërit e mij në Mitrovicë, profesori.

Pjesa e Dytë

Aurela Kadriu: A na tregon, tek sa keni shku si shqiptar në ‘64-tën në Beograd, qysh u trajtojshit si shqiptar atje, në Fakultet të Arteve osht’ interesant, ma specifike?

Adem Mikullovc: Shiko ky nacionalizmi serb, e shovenizmi ka ekzistuar edhe përpara. Po unë kom kalu mirë, nuk ka pasë ndonjifarë diferencimi, përveç një profesori. Një profesor m’ka thonë, “Kur të marrësh diplomën ka me qenë, n’diplomë ka me shkru, ‘Akademia për Teatër, Beograd’. Nuk m’intereson mu çfarë gjuhe ki me lujtë ti në teatër, duhet ta dish gjuhën serbe mirë”. Mund të them ky ka qenë i vetmi moment, mund ta quaj si acarim, a kërcnim a diçka asi soji. Përndryshe absolutisht nuk ka ekzistuar.

Dhe shikoni, ju jeni t'ri, ju nuk e dini, sa ma larg prej Kosovës, sërëbët ma nuk iu han palla për Kosovën. Beogradi s'don me ditë, bile pesë pare nuk i jepin. Shokët e mi, mazallah, s'dojnë më ditë, s'iu intereson, aspak. S'jonë t'ngarkumë sikur që jonë kta, sa ma knej. Bile serbisht osht' një fjali thotë, "Što južnije, to tužnije" Sa ma në jug, aq ma dhimshëm osht'. A din, e ka dallim shumë t'madh.

Aurela Kadriu: A ka pasë në gjeneratën e juj shqiptarë tjerë?

Adem Mikullovc: As një shqiptar. Në gjeneratën time nuk ka pasë as një shqiptar. Mandej ka ardhë Faruk Begolli, mandej ka ardhë Enver Petrovci edhe kështu me radhë.

Aurela Kadriu: A ekzistojke, ma përpara kur kemi folë diqysh krejt flasin për njëfarë solidariteti mes shqiptarëve, studentat e ri kur shkojnë, ata që jonë atje i presin...

Adem Mikullovc: Ka ekzistuar, ka ekzistuar ai solidariteti ka qenë...

Aurela Kadriu: Mes studentave...

Adem Mikullovc: Mes studentave shqiptar. Ka qenë edhe një shoqatë, s'di as si u thirrë, për Zotin, e studentëve shqiptar por unë nuk jom kyçë n'to, se nuk kom pasë kohë. Se para dreke i përcjellsha orët e mësimi në interpretim, e mas dreke i përcjellsha orët e mësimi në regji. Mandej kishim, lujsim nëpër shfaqje t'shumta, se Bekimi m'angazhoi nëpër teatra me nxirrë honorar. Lujsim një rol t'vogël këtu, një rol t'vogël atje. Një fjali këtu, një atje. Një statist këtu, një atje. Edhe s'kom pasë kohë t'mirë t'merrem me ta. Po ka ekzistuar ajo shoqatë, kanë punu programe edhe ata. M'kanë kritikuar mjaft që s'jom angazhu, po nuk kom pasë kohë. Kështu që kom mbetë jashtë saj.

Aurela Kadriu: Çfarë kanë qenë këto teatrot e vogla në të cilat jeni angazhu? A na tregoni pak?

Adem Mikullovc: Po ka qenë teatër, ka qenë Teatri Jugosllav, i ashtuquajtur Teatri Jugosllav i Dramës, ka qenë Ateleu 212, ka qenë Teatri Popullor i Beogradit, eh. Këtu osht' një anekdotë e mirë që une kom qenë prezent, po nuk e kom përjetu unë. Në një shfaqje, "Rikardi i Tretë", të Shekspir, një student, një kolegë i imi i lunte dy role. Në rolin e parë kishte veç me hi n'skenë, me kalu, faktikisht. A ma vonë, aktin e tretë kishte me tekst. Dhe hynë ai n'aktin e parë, i bërtet regjisori, "Idiot, kreten, qysh po ecë? Qysh po ecë ashtu n'skenë? Dilëm përjashta!" Edhe e përzen.

Vazhdon prova, hyn ai mandej me rolin e vet, që e ka me tekst, edhe e thotë rolin fantazi, e lunë mirë. Thotë profesori, "Ku osht' ai kreten i aktit të parë, që s'dike me ecë n'skenë?" Dikush i tha, "Profesor, ky osht' i njejt i kreten, ai i aktit të parë edhe në aktin e tretë". Ka qenë anekdotë e mirë, që shumë osht' folë nëpër Beograd asokohe.

Këtu, për shembull, që m'ka lonë mu mbresë ka qenë interesant aso kohe, megjithëse s'ka t'bëjë me mu fare, osht' koha e xhirit t'filmit "Mbledhësit e Puplave", të Bekim Fehmiut. U bo bujë e madhe në Beograd, kundërshtojshin me lujtë shqiptari, se ka qenë solizmi ma i madh, bash në Teatrin Jugosllav, Bata Zhivojinoviç¹ kundërshtonte. Ka qenë një, ajo këngëtarja Olivera Katarina, një këngëtare shumë e popullarizime, edhe aktore fortë e mirë... s'dojshin që Bekim Fehmiu ta lunë rolin kryesor. Regjisori

¹ Velimir "Bata" Živojinović (1933–2016) ka qenë aktor dhe politikan serb. Ai ka luajtur në më shumë se 340 filma dhe seriale televizive dhe konsiderohet si një ndër aktorët më të mirë në ish-Jugosllavi.

ishite kambëngulës edhe e lujti Bekimi rolin. Por osht' një skenë kur Bekimi asaj aktorës, Olivera Katarinës ia mëshon një shuplakë, s'di a iu kujtohet?

Aurela Kadriu: Po, po, po, po...

Adem Mikullovc: Eh. Ajo e ndërpenë xhirimin mas asaj skene, dhe thotë, “Ma ka mëshu privatisht”. Dhe e paditë Bekimin në gjyq. Dhe ditë t'tana, ndoshta tri-katër ditë shkrujnë gazetat, ajo nonstop tu e akuzu, edhe kolegët e saj, që Bekimi me të vërtetë privatisht i ka mëshu shuplakë asaj. Dhe Bekimi veç një here i osht' përgjegj, kurrë s'e harroj, “E vërtetë, ta kom mëshu me sa kom pasë forcë, por në rolin e Borës, në kuadër t'rolit, se privatisht as s'di kush je”. Dhe ia mbylli gojën, rolin ose luhet ose s'luhet. Ose luhet me krejt qenien tande, me krejt emocionin tond, shpirtin tond, ose s'ke bo kurgjo hiç.

Aurela Kadriu: A keni qenë i afërt me Bekimin?

Adem Mikullovc: Kom qenë i afërt shumë me Bekimin, kom nejtë me to shumë. M'ka ndihmu shumë, m'ka angazhu, tash kur ishim këtu në teatër, deri sa vdiq, për dy vjet, tri vjet, çdo verë vinte rrishim para teatrit, rrishim para teatrit, bisedojshim, shëtitnim bashkë. Po vishin njerëzit, donin të fotografohen me Bekimin. Bekimi nuk lejonte, kurrsesi nuk donte me u fotografu. E çon dreqi një ditë, një burrë me gru, me dy fëmijë m'njifnin mu prej këtyne serialeve të televizionit. Dhe m'afrohet ai burri m'thotë mu, une isha bash veç me Bekimin, m'thotë mu, “Baca Adem, a bon një fotografi? Na jemi të Zvicrrës, e ty t'dojmë shumë...” E ja nisi po m'i lavdon filmat e mij e qito sende.

Une me i tregu Bekimit që duhet të fotografohemi me adhuruesit thom, “Po more, qysh jo!” Dal e forografohna, një pozë, poza tjetër, poza tjetër, duke ja u përfaqfu fëmijët. Dhe tash burri i asaj gruje shtin dorën n'xhëp, i nxjerrë dhjetë euro thotë, “Urno, merri”. Thashë, “Shtini paret n'xhëp, mos t'sheh dikush!” Bekimi qaty ishte dy metra larg na shikonte, veç shikonte. Tha, “Merri, merri se ju artistat s'keni pare”. Thom, “Hiqi more ato pare mos...” Kur ajo gruja, gruja e ti e kapi n'dorë tha, “Merri, merri baca Adem, se edhe me atë majmunim në pllazhë t'madhe kemi pagu dhjetë euro kur jemi fotografu”. (Buzëqeshë)

Shkova une ngat Bekimit, tha, “A m'thu prapë me u fotografu une?” Thashë, “Nuk t'thom kurrë mo!” Dhe kurrë mo nuk i kom thonë fotografu me njerëz.

Aurela Kadriu: A folke Bekimi me juve për këtë rastin me Olivera Katarinën?

Adem Mikullovc: Jo, jo. Jo, ajo kanë qenë në çashtjet pak ma t'nalta, aty ku xhirohej filmi, unë shkojsha në Akademi edhe s'kisha kontakt as hiç bile me to, aspak. Po e përcillsha me vëmendje t'madhe. Interesant jemi na, kur vdiq Bekimi, boni vetëvrasje, pat' disa emisione në studio, i thirrshin njerëzit që s'kanë punu me Bekimin, që s'e kanë njoftë Bekimin, po e kanë pa n'film Bekimin. E lavdëronin, e qitnin në qiell, a në të vërtetë kurrë s'kanë pi kafe me to. Na jemi fort tipa interesant.

E njejta gja pat' ndodhë, mu nuk m'thirri kërkush edhe kurrë s'e pata rastin me dalë edhe me folë sa kom bashkëpunu, sa kom nejtë me Bekimin, qysh e kom njoftë unë Bekimin. E njejta gja pat' ndodhë edhe me Shani Pallaskën. Ishte një emision, s'di kush e pat' bo në KTV, Alban Morina, Fatos Berisha, e s'di kush ka qenë musafir... vdiq Shani Pallaska, folnin për Shani Pallaskën edhe t'gjithe ata flitnin, “Ekom pa bacën Shani n'këtë serial, e kom pa n'këtë shfaqje, kom nejtë me bacën Shani, ka qenë aktor...” Po asnji që ka punu me Shaniun!

A që ka punu me Shaniun ka qenë Lezja, une, Xhevati. Atëherë kemi qenë, Xhevati ka qenë gjallë. Unë kom luftë disa shfaqje, e kom pasë partner direkt, ditë e ditë, e ditë e netë, me mujë e mujë kom nejtë ka shtatë-tetë orë n'ditje me Shani Pallaskën. Dhe e di qysh ka marrë frymë Shani Pallaska. Ai e thrrret musafir aty shkun e vet për me thonë, “E kom pa, ka qenë i mirë baca Shani”. S'dina me bo na vlerësime. Duhet me ditë me i bo vlerësimet, me ditë kënd me thirrë, me kënd me bisedu, kush e ka njoftë, kush ka bashkëpunu, bashkëpunëtori i ngushtë, ai folë për to, si e ka pa ai.

Aurela Kadriu: Deri në cilin vit keni qëndru në Beograd?

Adem Mikullovc: Po, prej '64 deri '66.

Aurela Kadriu: Kur u kthyet në Kosovë çka...

Adem Mikullovc: E kom pasë une stipendinë, stipendionin, a e dini ju çka osht' stipendioni?

Aurela Kadriu: Po, po.

Adem Mikullovc: Prej teatrit. Ka qenë i lartë mjaft. Ka qenë sa rroga fillestare e aktorit. Jom kthy në teatër, jom punësu në teatër menjihere. Në vitin e parë. Nji vit ka kalu s'ma kanë dhonë asnji rol. Dhe fillova me hupë besimin në veti, a do të më jep dikush rol, a jo? Deri sa erdh profesori prej Beogradit, i cili m'njifte prej Akademisë dhe më dha një rol t'mirë. Mandej nji javë ditë prita me dalë kritika, se ma lavdunë rolin, kinse bona rol t'mirë, thojshin kolegët... Me dalë kritika me pa çka po shkrunë për mu. Nuk del kritika kurse si. Mas nji jave përmbi, shkrujti “Rilindja”, e lavdonte shfaqjen, e kritikonte shfaqjen, dhe n'fund, “Rolet i interpretunë ky, ky, ky...” Dhe n'fund, fjalja e fundit, “Dhe – Adem Mikullovc”. Kush ma keq s'e ka fillu karrierën në teatër se sa unë.

Aurela Kadriu: Cili ka qenë roli juj në këtë shfaqje?

Adem Mikullovc: Ka qenë shfaqja “Po shkoj për gjah”, Zhosh Fejdo nji shkrimtar i komedive, franqeze, nji tekst që luhej shumë. E lujsha nipin e Lezës, nji vagabond. Qasi ishte roli, njifarë vagabondi. Ishte rol i mirë, me t'vërtetë, ndoshta edhe s'kom qenë i keq me t'vërtetë, tash s'po muj me thonë që kom qenë i mirë, s'di sa kom qenë i mirë, osht' shume diskutabile. Por, kështu shkoi puna me atë shfaqjen e parë.

Aurela Kadriu: Qysh ka funksionu teatri në atë kohë?

Adem Mikullovc: Eh qysh ka funksionu teatri n'atë kohë, fatkeqësisht... Shikoni, ju rinia nuk e dini, ka pasë disa festivale nëpër Jugosllavinë e atëherëshme, ku na, shumë shpejtë, posaqërisht në kohën sa ishte drejtor Azem Shkreli, u bëmë ndoshta teatri më i fortë në Jugosllavi. Na kemi shku, kemi luftë shfaqje në Lublanë, Zagreb nëpër festivale. Ka qenë një disiplinë në teatër e jashtëzakonshme.

Në Novi Sad, aso kohe mbahej festivali i dramës, ku vetëm pesë shfaqje prej krejt Jugosllavisë kualifikoheshin për atë festival. Sarajeva s'ka mujtë me shku n'atë festival. Zagrebi s'ka mujtë disa herë më shku n'atë festival, na kemi shku, edhe Muharremi ka marrë shpërblimin për regji, Melihati për rol. Po na kemi pasë disiplinë t'hatashme. Te na u ditë, nji orë e gjysë para shfaqjes duhet t'jeshë n'garderobë. Nji orë e gjysë përpara duhet t'jem i veshun.

Se une po i shoh këta t'rijtë, kur e lujsha *stand up* komedinë time i shifsha, pesë minuta para se me fillu shfaqja vishin me vrapë, tu u deshë koridorit, tu e veshë kostimin, e me dalë në skenë. Ajo te na s'ka mujtë me ndodhë në asnjë mënyrë, në asnjë mënyrë.

Aurela Kadriu: A ka pasë trupë permanente të teatrit?

Adem Mikullovc: Po, qysh nuk ka pase trupë, kemi qenë 40 aktorë, 35-40 aktorë. Na kemi pasë shfaqje për çdo natë, bash për çdo natë. Vetëm t'haneve jo. Dhe ka pasë një periudhë, për shembull, kur lujsha katër role kryesore, katër herë n'javët kisha shfaqje me rolin tim. S'mujtje me u angazhu as n'film as kërkund për shkak t'repertorit. Dhe ekziston, iu kena përmbajtë asaj që gjithçka mundet me ndodhë, po shfaqja duhet t'luhet. Dhe ka ndodhë, unë s'kom qenë atëhere në teatër, po para se t'vi unë n'teatër që Masar Kadiut, aktorit tonë t'shquar, t'vjetër, i vdes vajza, e varros vajzën e vogël edhe n'mbramje vjen e lunë shfaqjen.

Shfaqja nuk osht' anulu në anjë kusht. Çun Lajçi, kemi qenë tu e përgaditë një shfaqje, "Hamleti në farmerka", një shfaqje moderne... Kur erdh lajmi, erdh Azemi i tregoi që i ka vdekë nana në Rugovë. Qajti Çuni, qajtëm edhe na, e ndërpreme provën, shkoi Çuni n'varrim t'nanës. Na tha regjisori, "Hajdeni mas dreke, n'mramje sonte n'provë, pa Çunin. Bojna provë, kështu improvizojmë, përsërisim pak tekstin dej t'na kthehet Çuni prej Rugove, që ka shku me varros nanën".

Dhe sapo fillumë ne provën, ka ora shtatë e mramjës, kur hyni Çuni. Kishte ra shi, e kishte lagë shiu, i zyrtë, i pikëlluar, m'u duk edhe ma i vogël. "Çka u bo Çun?" Tha, "E varrosëm nanën, hyna n'shipi, shpia zbrazët, gjithkah senet e nanës, teshat e nanës. S'ma murrë mendja me nejtë dhe erdha në provë". Dhe erdh n'provë. Kaq kemi pasë na përkushtim asokohe. Dhe të gjithëve na shtini me qajtë prapë Çuni për dashninë e tij, përkushtimin e tij. Ashtu ka qenë teatri im.

Aurela Kadriu: Çfarë ka qenë audienca e teatrit n'atë kohë?

Adem Mikullovc: Audienca ka qenë që ka qenë çudi nëse nuk shitet krejt salla. Kemi pasë shfaqje që nuk osht' shitë krejt salla dhe e kemi lu pesë-gjashtë herë dhe e kemi hekë prej repertorit. Salla përherë... dhe kanë qenë 500 vende në sallë. Tash jonë 300 e diçka. 500 ulëse kanë qenë, nonstop ka qenë plotë e përplotë, nonstop. Kështu që, ka ndodhë një shfaqje u shitë, se e kanë pa, ka dalë ai orari i shfaqjeve u ditë, u shitë gjatë gjithë muajit, ka qenë shfaqja një mujë pëpara e shitne për krejt mujin. Pesë shfaqja këtë muaj, t'pestat jonë shitë. Dhe s'ka biletë, s'ka biletë.

Po edhe nuk i kemi pasë televizionet sikur se i kemi sot, nuk i kena pasë kafet e sotit, nuk i kemi pasë ahengjet që i keni ju sot. Teatri ka qenë ngjarje. Ka qenë ndodhi. Unë e di me siguri që njerëzit kanë qepë rroba për premierë t'shaqjes që po vjen. Kanë ble tasha.

Aurela Kadriu: A iu ka ndodhë ndonjhere në shfaqje me pasë najfarë provokimi, najfarë ndërhyrje për shkak të gjendjës politike që ka qenë?

Adem Mikullovc: Jo, nuk ka pasë. Kemi pasë, ndoshta vlenë ta përmendi, shfaqjen "Halili e Hajria", po viti, dikun vitet e... Ah vitet, ku me i mbajtë n'mend vitet, kur filloi rilindja jonë kombëtare pak ma tepër, të ngritemi ne, dhe lujshin aktorët. Po ka qenë një skenë, ku Pashën e lunte Shani Pallaska, Ragip Hoxha dhe Malogami, dhe i dënojshin me vdekje, me iu pre kokën Xhevdet Lilës, Shaban Gashit edhe Isa Qosjës, regjisorit. Dhe tash, shiko me qenë se ishte teksti kur thonte Shaban Gashi, "Se besa e

shqiptarit nuk i jepët një t'hujit", nuk mujshe mu ulë me kallë cigaren, qaq kishte duartrokitje dhe brohoritje n'sallë.

Bile, bile dikun, nuk e di, në Mitrovicë më duket, del një tip ulet n'skenë përpara dhe dirigjonte publikun kur me duartrokitë. E n'fund t'shaqjes Shaniu, Ragipi, Mala u frigojshin me dalë, se u frigojshin mos dikush në të vërtetë po i sulmon. Qaq që ishte ngritë ai emocion, të them, kombëtar.

Aurela Kadriu: E Prishtina çfarë qyteti ishte kur u kthyet prej Beogradit me vazhdu me jetu...

Adem Mikullovc: Prishtina ishte qytet që, mazomokeq çka i kanë bo, e kanë marrë n'qafë. Unë s'jom prishtinali por kanë qenë dy lumenjë nëpër qytet, ka pasë dy lokale, dyqanet e vjetra, ambëltoret e vjetra, terzitë, sahatçitë, këta saraqët e ndryshëm, zanatlitë e shumë. Ka qenë qytezë. Qytezë, taman qytezë gjysëm orientale me shumë ambëltores. Po pak kafe, pak kafiqa. Qytetarët kryesisht kanë qenë t'dhanun mas sportit, jetës kulturore. Qeshtu kemi qenë.

Aurela Kadriu: Cila ka qenë lagjja e parë që keni jetu në Prishtinë?

Adem Mikullovc: S'di qysh thirret, te ky trekandëshi {tregon me dorë nga dritarja}, kjo përmendorja te komuna, qaty kom banu me qera, te një serbe kom banu ma s'pari me qera. Nja dy vite kom qenë si qiragji, ndërrojsha banesa, herë këtu, herë atje deri sa... se atëhere jepshin kuvendi, jepte banesa. E me qenë se une veç depërtova si aktor, pak fillunë me më çmu si aktor, s'di sa kom vlejte me të vërtetë, m'erdh radha, ma dhanë banesën. Hyna n'banesë time.

Mandej po atë banesë që e kom marrë prej teatrit, qatë banesë e kom shitë, kom bo shtëpi në Bërnice. Kom shtu edhe pak t'holla dhe e kom bo shtëpinë në Bërnice. Nji gja që tash me juve rininë nuk mund të ndodhë. Kush ta jep banesën tri dhomëshe ty? Kërkush hiç. A mu ma kanë dhonë.

Aurela Kadriu: A jom gabim apo e keni pasë edhe në këtë periudhë një angazhim politik, apo jom gabim?

Adem Mikullovc: Jo, nuk je gabim. Pa shiko, kur thu angazhim politik, kam dëshirë ta sqaroj një gjë, unë nuk e konsideroj që po mirrem me politikë se s'jom politikan. Unë jom deputet. Deputet që m'ka zgjedhë populli, m'ka besu të jem përfaqësues i popullit me votat e tyne. Me punë t'qeverisë andej, kënde, nuk di me u marrë, as s'mirrem. Unë mirrem vetëm me punën e kuvendit, aty kontribuoj sa t'mundem.

Unë kom qenë, i përkas edhe asaj gjeneratës të kuvendit që në 1990-tën e kemi shpallë deklaratën kushtetuese dhe kushtetutën e Kaçanikut. Po edhe ky osht' interesant, tregim n'veti. Isha aq shumë i ngarkumë me shfaqje dhe në të njëjtën kohë e xhirojshim edhe një film, dramë televizive në të vërtetë, që unë nuk e kam ditë që unë jom n'listë për votim, që po votohna për deputet. Dhe jom zgjedhë dhe nuk jom shku kurrë n'mbledhje. Dy-tri mbledhjet e para s'kom shku, deri sa kanë ardhë prej kuvendit m'kanë thonë, "Ec more, se ti je deputet". "Çka jom unë?" "Deputet". "E çka me bo atje unë?" "Me folë për teatër, për kulturë, për art..." Edhe atëhere mendej kom shku ajte.

Me qenë se ai sistemi komunist kanë qenë, u ditë përpara kush ka m'u zgjedhë. Dhe i kanë qitë ka dy kandidatë. Kom qenë unë dhe një tjetër për të njëjtën pozitë, për deputet, për kulturë. Vetëm dy kemi qenë. E thonë, që m'kanë thonë këta, tash po m'tregojnë n'kuvend, që kanë, i kom pasë diku 600.000

mij vota, alamet shumë vota, e kom shkelë atë tipin tjetër (buzëqeshë) dhe m'kanë zgjedhë mu. Unë as s'e kom ditë që jom zgjedhë deputet.

Aurela Kadriu: Qysh ka qenë kjo pjesë e jetës t'juj? Kjo shkëputje pak prej artit.

Adem Mikullovc: Po me t'thonë t'drejtën, jo e mirë. Asokohe une hyna deputet në të '90-tën si thashë, me qëllim që të luftoj me hapë edhe një teatër, me hapë teatrin e kukuallave, që më vonë edhe e bëmë teatrin "Dodona". A din, të kultivoj kulturë. Mirëpo kishte demonstrata, vrasje, burgosje. E hongër drejt krejt shkoj, e pashë që s'osht' rendi i kulturës, as rendi i teatrit dhe u kyça edhe une në vazhden e vendimeve që i murrë kuvendi asokohe. Në bashkëpunim me profesorët që na diktojshin, na ndihmojshin, Gazmend Zajmi, e tjerë, e tjerë.

Aurela Kadriu: Ndërkohë, a vazhdojshit me qenë edhe në teatër?

Adem Mikullovc: Absolutisht n'teatër! Se shiko, ka dallim. Une sa kom qenë, një vit ka zgjatë ai mandati im, as një cent s'e kom marrë prej kuvendit. Nuk jemi pagu. Kemi marrë rrogat aty ku kemi punu. As një cent, kurrë, kurrë, as meditje as hiç kurgjo. A tash osht' rroga shumë e mirë n'kuvend. Gjithkush ka marrë rrogën aty ku ka punu. Kështu ka qenë.

Aurela Kadriu: E qysh ka qenë teatri në të '90-tat? A osht' mbyllë teatri?

Adem Mikullovc: Jo, nuk o... ma vonë u mbyllë, ma vonë. S'e di n'cilin vit u mbyllë teatri. Nuk osht' mbyllë as njihere teatri në të vërtetë. Ka vazhdu. Po kanë ardhë masat e dhunshme. Ka ardhë drejtori serb, iu ka diktuar repertorin, një regjim krejt tjetër. A të '90-tën jo, jo, kom luftë shfaqje. Bile ka ndodhë, dy here, a tri here, u anuloi shfaqja për shkak që isha i zanun në kuvend, me mledhje në kuvend, po.

Aurela Kadriu: Kur u mbyll teatri, çka keni bo?

Adem Mikullovc: Une mandej s'jom kthi kurrë në teatër. Se si deputet i kuvendit, na kur e shpallëm kushtetutën e Kaçanikut në Kaçanik, na ikëm prej Kosove. Na shkumë në Slloveni, njihere në Kroaci, mandej në Slloveni. Me këtë që të ekziston kuvendi dhe të merr vendime kuvendi. Dhe me vendimet e kuvendit, 2 korrikut që e quajmë ne, ka jetu Kosova deri u paraqitë UÇK-ja, deri në luftë...

Aurela Kadriu: Çka kanë qenë këto vendime?

Adem Mikullovc: Kushtetuta ka qenë... kanë qenë zgjedhjet e lira, referendumi për pavarësi, me majtë shëndetësinë, me majtë arsimin, shkollat private nëpër shpija. U dashtë me i menaxhu krejt këto sene. Krejt këto i ka bo kuvendi i 2 korrikut. Na i kemi bo prej Sllovenie. U zgjedhë qeveria e përkohëshme në ekzil, me Bujar Bukoshin si kryeministër, e tjera, e tjera. Kemi punu.

Aurela Kadriu: A keni pasë najfarë presekutimi për shkak të angazhimit t'juj?

Adem Mikullovc: Kom pasë persekutim se une kom ardhë prej Sllovenie kom ardhë në Prishtinë me pa djalin edhe grunë. Djalë kryesisht. Dhe duke u kthi, m'kanë zonë policia dhe m'kanë çu n'burg. Dhe kom qenë në burg në Valevë, m'kanë majtë pak ditë, tetë ditë, shtatë natë, qashtu e ka rrokë. Dhe m'kanë liru me mbrojtje n'liri, se sikur që thashë n'fillim serbtë sa ma larg prej Kosove, s'iu hanë palla për Kosovën. Gjykatësi dhe prokurori u çuditshin, me m'burgosë me kërkesën e sërbevëve të Kosovës, për shkak të diskutimeve t'mia në kuvend, a deputeti ka imunitet.

Bile m'thanë, kur m'lrinë, m'thanë, "Shumë t'kemi majtë". Metë të më thërrasin prapë me shku n'gjykim mu m'mbrojtë n'liri, m'kanë thirrë dy here, po unë s'kom shku mo, e hongër dreqi nuk shkova kurrë.

Aurela Kadriu: Pse s'u kthytë në teatër?

Adem Mikullovc: Nuk kom dashtë mu kthy në teatër. Iu përvësua punës, fillova me bo filma televiziv, me video kasete, drama televizive, seriale, dhe serialet masnej i bona pesë-gjashtë seriale. Nuk kom dashtë në teatër m'u kthy mo. Sa ishin serbët, sa ishte drejtor ai serbi, s'di qysh e ka pasë emrin, Zhariq, a s'di qysh e ka pasë emrin, ai m'ka thirrë, mos me rrejt. Kur u lirova prej burgut m'ka thirrë me shku. Kom thonë, "Sa t'jesh ti drejtor unë n'teatër nuk..." Dhe s'kom dashtë me shku. S'kom dashtë me shku. Mandej mas lufte mo veç u plaka edhe...

Aurela Kadriu: Me çfarë projekti keni punu në këtë kohë? Çfarë seriale, cilat? Ndoshta kishte qenë mirë...

Adem Mikullovc: Po serialet i mija jonë... çka di une! Ndoshta ma i popullarizuar osht' "Mahmutovitet dhe Rexhepovitet", "Mahalla jonë" serial gjithashtu. Mandej seriali "Katundarë e Sheherli", mandej seriali "Burri me tri gra". Mandej seriali për RTK, "Zogjtë e luftës", njëzet epizoda për jetimat e luftës. Mandej seriali në 21, "Rrëfimi nga gjyqi". Qeto jonë serialet e mia. A kom pasë plotë filma televiziv, jonë njëzet e kusur filma televiziv. RTK i kom njo tri apo katër drama, katër drama televizive që i kom realizu, tash prej që u formu RTK, mas lufte, që i kom bo. Qishtu kom punu.

Aurela Kadriu: Çfarë lloj satire, çfarë lloj humori ka qenë sidomos te "Mahmutovitet dhe Rexhepovitet"? Osht' shume e njoftun, ajo osht'...

Adem Mikullovc: Po...

Aurela Kadriu: Pjesë e kujtesës kolektive noshta.

Adem Mikullovc: Po qashtu osht' ajo. E vërtetë.

Aurela Kadriu: Çfarë lloj satire ka qenë për juve?

Adem Mikullovc: Po, ai ka qenë, jom mundu me qenë humor popullor, duke ngacmu, si të them, vetitë negative që i kem ne si komb. Për shembull, mos me çu mirë me fqin, mospërfillja njeni me tjetrin, konfliktet e tilla, martesat e tilla. Aty e kom pasë përqendrimin kryesisht, gjë që osht' edhe sot e kësaj dite te na. Mjafton sot ta shohësh në kuvend çfarë antagonizmi ka mes partive, unë po çuditem dhe po jes pa mend, dhe po thom, "Vallahin, s'kom qenë larg, s'e kom bash keq 'Mahmutovitet dhe Rexhepovitet' tu ju pa juve". (Buzëqeshë) Se vërtetë jemi të tillë.

Aurela Kadriu: Në cilin vit osht' xhiru "Mahmutovitet dhe Rexhepovitet"?

Adem Mikullovc: Ah mori vajzë, mu me vite, vitet janë numra, si t'përmenden numrat mu fshimë lirisht. Nuk e di për Zotin n'cilin vit ka qenë.

Aurela Kadriu: Ku keni qenë gjatë luftës?

Adem Mikullovc: Gjatë luftës kom ikë n'Mal të Zi. Në Ulqin kom qenë. I pata... Në banesën time, përballë meje jo, po një kat ma poshtë meje ka qenë një malazez, major i UDB-ës, i policisë, edhe i thashë, një dy-tre mujë para se me, kur u acarua puna i thashë, "Dragan, qysh t'na vjen puna, ose ndihmon ti mu shpëtom ose unë t'shpëtoj ty". Dhe ma dha fjalën malazezi që qashtu do t'ia bajmë. Nëse vjen puna keq për serb e malazez, unë me i ndihmu atij, me shpëtu. Dhe ai njeri, nuk e di ku osht', a osht' gjallë a nuk osht' gjallë, major i UDB-ës, m'ka marrë me makinë, mu, grunë dhe djalin, nëpër Mitrovicë, nëpër Rashkë, në Mal të Zi, në Ulqin. M'ka qitë atje.

I ndërrum telefonat, po kurrë ma s'mu lajmëru në telefon. Se ai tha, "As unë s'do të kthehna, do të dezertoj prej ushtrisë, policisë..." A e kanë vra, a ku osht' vra, a s'o vra, a çka u bo me to, nuk e di. U mundova t'ia jepi dy mijë marka asokohe, marka ka qenë me pare, s'i pranoj në asnjë mënyrë. Në asnjë mënyrë nuk i pranoj. I njejt i njeri i ka ndihmu me ikë edhe Masar Stavilecit të ndjerë, babës të Blerand Stavilecit. Dhe kur policia e kanë marrë Blerandin, se Blerandi ma i madh se djali jem disa vite... S'di sa i ka pasë Blerandi, dy-trembedhjetë vjet, pesëmbëdhjetë vjet... Qaj malazezi ia ka shpëtu djalin Masarit, e ka marrë prej policie, ia ka çu n'shpi djalin.

Aurela Kadriu: Qysh ka qenë me xhiru filma para luftës? Qysh u xhirojshin filmat para luftës, qysh ka qenë me xhiru filma para luftës?

Adem Mikullovc: Paj, çka t'them bre vajzë. Na para luftës filmat krejt i kanë realizu kompanitë e Beogradit, dhe Zargrebi. Ata jonë ma zanatli se na, domethonë punojnë ma mirë edhe paguajnë shumë ma mirë, me t'thonë t'drejtën. Na tash, dalë ngadalë po mësohemi dhe kanë dalë t'ri, moshatarët e tu, t'cilët po e shof, po depërtojnë aty këtu. M'bon knaqësi, për shembull që filmi i Agim Sopit, "Agnus Dei", ka marrë një qind shpërblime nëpër festivale t'ndryshme. Po i marrim hapat dalë ngadalë por ende jemi larg. Ende jemi larg.

Tu i pa serialet e mia e filmat televiziv t'mitë, m'kanë ardhë tre djem të Zvicrrës para dy viteve m'thanë, "Baca Adem, kena vendosë me ta financu, me bo film për Adem Jasharin". Unë menxi iu spjegova atyne djemëve që na nuk jemi në gjendje me bo film për Adem Jasharin. S'kemi forcë. Me u bo bashkë na me Shqipërinë prapë s'mujmë me bo atë film. Osht' alamet i shtrejtë, alamet kostumi i policisë, alamet teknikë e Serbisë, ku o skenografija... se ma s'pakti roli, roli gjindet dhe e bon dikush.

Dhe qysh m'tha njëni ekziston një legjendë, sa osht' e vërtetë nuk e di, që paskan folë shqiptarët me Mel Gibsonin, dhe ai ka tregu interesim të madh me ardhë me bo atë film. Veç Hollivudi mundet me bo atë film, na jo, në asnjë mënyrë, në asnjë mënyrë. Për me bo film t'mirë po flas, se me llapërqitë...

Aurela Kadriu: A keni punu në regji naj here, naj kohë?

Adem Mikullovc: Krejt qito sende e kom bo regjinë une, që i përmenda serialet. Krejt këto jonë regjia ime. Edhe dramet televizive në televizion. Edhe në teatër kom bo shtatë a tetë shfaqje regjinë. Regjinë e kom pasë dashninë e dytë (buzëqeshë). Se thashë në Akademi në intepretim i përcjellsha orët para dreke, mas dreke regjinë. Dhe bile gjithë kohën kom qenë në dilemë, mos gabova që s'shkova në regji, e morra interpretimin.

Aurela Kadriu: E përmendët më herët hapjen e televizionit, a keni qenë i ndërlidhur me televizionin naj qysh? A keni punu a diçka?

Adem Mikullovc: Kena bashkëpunu, me televizionin kena bashkëpunu kur u hap televizioni shqip dhe fillunë serialet e para. Ishte ngjarje asokohe, i bënte regji Muharrem Qena, seriali “Qesh e Ngjesh” humoristik, luhej një herë në javë, pritej kur vjen e shtundja me e pa “Qesh e ngjesh”. Mandej mas “Qesh e ngjesh” erdh seriali “Pa pengesa”, edhe aty. Mandej dramat televizive, une muj me thanë sipas mendimit tim, ashtu mendoj, që kom lujtë dramën e parë televizive të prodhimit të Prishtinës, tonën, “Skerco”, në regji të Muharrem Qenës. Drama “Miu në xhep”, komedia “Miu në xhep”, po e ndërroi titullin “Skerco”.

Kena punu edhe atëhere shumë. Aq kena punu shumë, gjenerata e aktorëve asokohe, sa që na ka ndodhë mu, Dibranit, Çunit e tjerëve plot mos të harroj Kumrie Hoxha, Drita Krasniqi e disa të tjerë, që kemi qenë para dreke në provë, mas dreke në provë, në mbramje shfaqje e gjithë natën televizion xhirim. E plus në radio na pritke emisioni “Humoreska”, “Ora Gazmore”, “Radio Drama”, na nuk mbrijsim. Absolutisht nuk mbrijshe të gjitha me i bo. Kur filloi edhe Kosovafilmi me na angazhu, atëhere hupëm krejt.

Aurela Kadriu: Çka bojshit te Kosovafilmi?

Adem Mikullovc: Po për te filmi Kosovafilmi, ka bo filma t’mirë Kosovafilmi. Ka bo “Era dhe Lisi” për shembull filimin, e filma shumë tjerë ka bo. “Proka”, po ishte i ri, jo, m’fal, “Proka” osht’ vonë. Kosovafilmi, ka bo filma, kemi xhiru.

Aurela Kadriu: Kur u kthytë prej luftës, qysh e gjetët...

Adem Mikullovc: Kur u ktheva prej luftës, mirë e gjeta, osht’ anekdotë interesant se dashta me e marrë ni libër, e pata lanë afër televizionit, televizorit, dhe në libër i pata lanë 2000 marka. Dhe kur erdh, iu thashë shpejt me dalë, “Merre grunë, dil, qysh jeni qishtu shpejt me hypë në kerr”. U nisëm për Mal të Zi me ikë, thashë, “Veç te marrë librin”, “Le librin mos e merr”, s’më la me marrë librin ai. Edhe shkumë në deti. Shkumë në Mal të Zi. Derën ma ka thy ni kojshi poshtë, ka dashtë me ma zaptu banesën. Kur u ktheva e gjeta derën e thyme, po nejse, hinëm në banesë dhe shkova te libri, libri afër televizorit, 2000 markat ishin në libër, s’ka ditë m’i gjetë, s’ka ditë m’i kapë. Kur jonë tuat, tuat jonë, badihava. S’munet kërkush me t’i marrë.

Aurela Kadriu: Çka keni vazhdu mandej me punu mas luftës? Qysh u ringjallët? Qysh e gjetët vetën?

Adem Mikullovc: Po qashtu, fillumë me kasete. Fillova me bo humor, xhirojsha humor ma tepër, skeqe, muzikë bojsha, punojsha për tjerët se unë vetë s’kisha mjete. Deri sa një ditë, trokiti dikush në derë. Ky o tregim interesant. Trokiti *dum, dum, dum* në derë me forcë. Dhe isha duke hangër mëngjes me gruan time, djali ish i vogël, a në shkollë ishte djali. Dal e çeli derën, ni djalë para meje. Thashë, “Pse po troket? Çka po don?” Tha, “Bukë.” Thashë, “Çka?” Tha, “Bukë”. Zakonisht vishin lypsat, na kanë ardhë gjithmonë, jo lypin pare, e kom smut dikënd, s’di çka, ndonji teshë, e ai më lypu bukë.

I thashë grusë time, “Lume bre, kqyr jepja një, jepi diçka me hangër kti djali”. I jep gruja ime, ia bon një sendviç, me sallamë a me s’di çka, edhe me djath edhe i jep. Unë vazhdoj me hangër mëngjes, po më thotë gruja, “Eja, eja te dritarja.” Kur shkoj te dritarja, jonë ulë te kantat e bërlllogut, kontejnerët, ai me një djalë tjetër, po e hanë ata bukë, me aso shije, p’e gëlltitin, p’e përbijnë. Ish leckan. Ish i mjerë. Dola,

shkova te ta, fola kush jonë, çka jonë. Tregunë, më thanë, baba ju ka vra në luftë, e nana u martu, po jetojnë me gjyshën në një podrum. “Eh,” thashë “Adem Mikullovc, po bënë humor, a qy çfarë drama ka.” Më fal veç diçka, nuk osht’ kështu... Osht’ fjala qe babën e kishte në burg, jo të vramë po në burg, babën në burg, nana e ka lanë e u martue. Këta kishin mbetë me gjyshën. Kush po kujdeset për të burgosurit politik? Dhe për tri ditë e kom shkru skenarin për filmin “Një pallto për babain tim në burg”. Për tri ditë e kom shkru, Shani Pallaska rolin kryesor. Por kisha problem me e gjetë atë djalin. S’di a e keni pa ju këtë film a jo?

Aurela Kadriu: Po, kam ndëgju për to.

Adem Mikullovc: Eh, ka qenë hit filmi. Tonë m’i bijshin do djem të qokolladave, e prek këtu del gjaku këtu. A unë e dojsa një të mirë. A ky që e luji rolin ky, nonstop tu u sillë para teatrit, “Baca Adem a don cigare, baca Adem a don cigare?” Deri sa m’u çelën sytë e i thom, “Ndal, kush je ti?” E marr, e çoj në banesë, e shti me lexu tekstin, e pashë që mundet. Mandej kom punu me to nja një javë ditë, a ditë, ditë mirë, deri sa kemi dal në xhirim. Qishtu më ka ndodhë me to.

Kjo kështu, ndodhin këso gjana, ndodhin, duhët me ekzistu një xixë, një inspirim për me angazhu njeriun. Isha në autobus, prej Mitrovicës shkojsa në Pejë. Dhe te Banja e Pejës, hyn një djalë i ri, i zbehtë, i dohtë, si une fizikisht. Ulet pranë meje. Po e shikoj me bisht të synit, pantallonat e vjetra, këpucet e arnume, njëfarë kmishe e ndrydht, kurrfare. Thom, “Çka punon ti bre djalë?” Tha, “Unë, baca Adem,” se ai më njofti “Jom mësues, jepi mësim. E kom klasën në Boge”, në Rugovë, nalt. Thashë, “Përditë udhëton?” Tha, “Jo valla, bash çdo ditë jo, po në çdo të dytën ditë, tretën ditë, po më bjen me shku se e kom nanën këtu. E prindët s’i kom mirë, po duhet me u kujdese, e po udhëtoj.” Edhe më tha, “Jom liru prej burgut që një mujë ditë. Kom qenë 7 vjet në burg.” “Hej more Zot!” Thashë.

Edhe këtu sikurse për atë djalin për katër-pesë ditë e shkruva dramën, atë filmi, skenarin, për filmin “Mësuesi”. Dhe e bona bash qysh më tha ai; që ka dalë prej burgut, ka hy në shkollë në Boge, por në të vërtetë e kanë liru prej burgut për me vdekë në shtëpi të vet se e kanë mytë në burg. Ai faktikisht ka qenë njeri i vdekur, i mbytur, i vramë. Prishë veshkat, prishë zemrën, prishë krejt, dhe ai vdes. Dhe ai vdes atje.

A e din, po du me thanë, gjithmonë ekziston një xixë, që e nxitë njeriun me i hy një pune si inspirim e mandej, mandej shkon. Kur e xhirojsa serialin “Mahalla jonë”, ty montu diçka, s’di çka, diçka, isha tu e montu diçka ni film dhe montazheri po më thotë, “A pajtohesh me tezën time?” Teorinë time. Diçka ma tha diçka një temë, një përmbajtje, edhe për me lu hajgare më tha, “A pajtohesh me tezën time?” E shikova, fantazi. Tri episoda i kom bo të serialit “Mahalla jonë” me qatë fjali, me tezën time.

Se e lidha skenarin, Xhevat Qena dhe Zenel Tufa, Xhevati i thonte Zenelit, “Martohu, të ka deké gruja.” Në qatë kohë, deri sa kta bisedojnë për martesë, vjen gazetarja dhe i pyet për sëmundjet ngjitëse. Ju manë një ligjeratë dhe në fund ju thotë, “A pajtoheni me tezën time?” Kta thonë, “Po more, pajtohem, qysh jo?! Veç a e don teza se gjithqysh pajtohem.” Mandej tri episoda e kom ndrydhë e shtrydhë atë fjali, ni fjali të Zotit, “A pajtohesh me tezën time?” Osht’ inspirim. Mendoj që kush mirret me art duhet ta gjejë dikund, të kapët dikund, një inspirim, të inspiron një pikturë, një muhabet, një tregim, një shikim i një njeriu.

Aurela Kadriu: Qysh vendoset mandej me e shtri angazhimin e juaj në Kuvend?

Adem Mikullovc: Eh, angazhimi im në kuvend është, të themë të drejtën unë gjithmonë shiko e kom pasë banesën te Aleanca, dhe përditë shkojsha te Ramushi me luft shah, e me pi kafe e me nejt me ta. Po i thojsha në ftyrë Ramushit që une jom me Vetëvendosjen!, adhures i Vetëvendosjes!. Bile ai më thonte, “Çka po don me ata baraba të Vranjfevcit? A je tranu, hajde te une në parti, unë po të shti po të boj deputet”. S’dojsha me shku.

Po kur dola ktu me shpi në Bërnice, kom pasë njëfarë njoftësie, njohje, njëfarë jaranie të cekët me Albin Kurtin. Më erdh Albini me këmbëngulje, dy-tri here, me u bo deputet, m’u kandidu. “O nuk më zgjedh mu kërkush...” i thojsha. “O po, po”. “O s’jep kush votë për mu”. Doli që morra 13000 a s’di sa, morra shumë, pranova dhe u angazhova të jem pak më aktiv në Vetëvendosje!.

Aurela Kadriu: Per çka angazhoheni sot? Për çfarë çështje angazhoheni në kuvend?

Adem Mikullovc: Pa shiko, është interesant, diskutimet e mia, kërkesat e mia, asnjëherë nuk i dhanë mediat. Po angazhohem për disa çështje që jonë pak ma vitale për Kosovën. Për shembull, jom anagazhu, pse mos me e paditë Serbinë deri tash me gjyq? Për gjithë atë vrasje, për gjithë ata t’zhdukur, gjithë këto shkatërrime ekonomike, një qind e njëzet mijë shtëpi. Dhe na ende s’kemi ngritë asnjë padi kundër Serbisë. A duhet s’paku dhjetë, pesëdhjetë padi. Veç Reçaku duhet një padi, Krusha e Madhe një padi, Prekazi një padi. Këtë e kom paraqitë.

Tash këto ditë jom angazhu pak ma tepër rreth Fondit të Penzionistëve dhe kursimet e qytetarëve që i kanë pasë bankat e JugoBankës, me i kthy Serbia, se e ka vjedhë Fondin e Penzionistëve të Kosovës krejt. E qeshtu, po mundohna aty ku mendoj pak ma mirë, me kontribu pak ma shumë nëpër komisione, nëpër punë të ndryshme.

Nesër e kemi seancën, i kom dy pyetje pak t’kqija me ua u bo. Se dua me dalë me propozim, me i propozu kuvendit që me qenë... se neve Serbia po na thërret në vazhdimësi edhe n’letra, n’akte, kudo që shkrinë Kosova dhe Metohia, unë do të propozoj nesër që na me iu drejtu Serbisë prej tashit Serbia, Vojvodina dhe Sanxhaku. Vojvodina osht’ krahinë autonome e Serbisë, Sanxhaku osht’ një aneks i Serbisë me shumicë të popullatës jo serbe.... Edhe ne atyne me ua ndërru emrin. Ata neve Kosova dhe Metohia, na atyne Serbia, Vojvodina dhe Sanxhaku.

Nuk e besoj që e aprovon kuvendi se do të bëhet skandal. Paramendo Vlora Çitaku në Kombet e Bashkume nëse thotë Serbia, Vojvodina dhe Sanxhaku. Delegacioni serb ka me lëshu mledhjen menjëherë. Bisedimet tash që po i bojna me Serbinë, nëse këta tontë i përmbahen asaj dhe nëse gjithmonë n’shkresa, biseda thonë Serbia, Vojvodina dhe Sanxhaku, po t’garantoj kanë me i ndërpre bisedimet; qe qesi jom une, kom mbetë kavgaxhi. Jom ngucakeq.

Aurela Kadriu: A vazhdoni me u marrë me film dhe teatër?

Adem Mikullovc: Jo. Jam dorëzu.

Aurela Kadriu: Qe sa kohë?

Adem Mikullovc: Qe sa, prej se jom bo deputet. Nuk po muj me mrrri. Edhe shfaqjen time në teatër e lashë, s'po muj mo me lu. S'po kom forcë, një ore e pesëmbëdhjetë minuta vet me lu veten në një shfaqje... E pashë që shfaqjet e fundit i lujsha ma tepër i ulun, se sa n'kambë ose t'u lëvizë. S'bon me zor. Edhe e lashë. Para një dy-tri ditëve m'thirri një djalë, "Një film baca Adem, film t'shkurtë..." Thashë, "Fshije, une e kom kry!" Mirë, keq, kom bo çka kom bo, qajo që osht'.

Aurela Kadriu: Nëse nuk keni diçka me shkru, mujna me përfundu. Faleminderit shumë!

Adem Mikullovc: Po, nuk po di une qysh do t'na del kjo bisedë me t'thonë t'drejtën. Shikuesve a do t'iu pëlqen, a s'do t'iu pëlqejnë këto kujtimet e mija, emocionet e mia. Unë du m'i përmbledhë pak por, pak thamë e kanë mbetë shumë pa thanë. Si çdo njeri, secili prej neve që kemi shumë, e shumë, e shumë me spjegu jetën tonë. Por kryesore, mbajeni n'mend, kjo jetë osht' veç shuplaka, veç shuplaka dhe shumë pak puthje.